



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine - Ministry of Industry,
Entrepreneurship and Trade

Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë

Thirrje publike për aplikim në shtandin shtetëror të Kosovës në panairin
“SLUSH 2024” në Helsinki/Finlandë

Data e organizimit:

20-21 nëntor 2024

Adresa: Helsinki, Finlandë

Me qëllim të promovimit të kompanive kosovare të sektorit të teknologjisë informative dhe komunikimit, në gjetjen e tregjeve të huaja për eksport të produkteve, Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT) përmes Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA) fton bizneset të aplikojnë përmes kësaj thirrje që të jenë pjesë e këtij aktiviteti ndërkombëtarë. KIESA mbulon shpenzimet e hapësirës ekspozuese, ndërtimin e standës (pikë kontaktuese dhe qasje në hapësirat e hapura dhe të mbyllura për takime B2B për çdo takim që aranzhohet me kohë), regjistrimin e deri 6 subjekteve pjesëmarrëse nga sektori i teknologjisë informative dhe komunikimit, shpenzimet e energjisë elektrike, pastrimin ditor, etj., ndërsa shpenzimet e udhëtimit, akomodimit, ushqimit, dërgimit të materialeve promovuese, etj. të subjekteve pjesëmarrëse do të merren përsipër nga vet subjektet pjesëmarrëse.

Afati për aplikim për pjesëmarrje është deri më 10.10.2024. Dokumentet e plotësuar si në vijim do të konsiderohen për vlerësim.

1. Aplikacioni i plotësuar më të dhënat bazike të subjektit aplikues;
2. Dëshminë që subjekti aplikues është i regjistruar në Republikën e Kosovës;
3. Dëshminë e xhirollogarisë aktive në njërin prej bankave të licencuara nga Banka Qendrore e Kosovës;
4. Kopjen e letërnjoftimit të personit të autorizuar të subjektit aplikues;
5. Vërtetimin nga gjykata që dëshmon që personi i autorizuar i subjektit nuk është nën hetime (kërkohet origjinali, jo me i vjetër se 30 ditë);
6. Deklaratën nën betim;
7. Vërtetimin e qarkullimit vjetor të subjektit aplikues për vitin fiskal 2023 nga Administrata Tatimore e Kosovës (Gjendja e përgjithshme e deklarimeve dhe transaksioneve të tjera nga ATK); dhe
8. Vërtetimin tatimor të subjektit aplikues për obligimet e kryera ndaj ATK, jo më e vjetër se 90 ditë nga data e lëshimit.

Në mungesë të cilit do dokument të kërkuar në listën e mësipërme aplikacioni i subjektit aplikues do të diskualifikohet. Për këtë aktivitetet sipas kriterëve në vijim dhe vlerësimit të pikëve do të përzgjidhen 6 subjekte:

Kriteret e vlerësimit:

- Produktet që subjekti aplikues do të ju ofrojë blerësve potencial në panair, maksimum 10 pikë:
 - 1 pikë për 1 produkt
 - 3 pikë për 2 produkte
 - 5 pikë për 3 produkte
 - 7 pikë për 4 produkte dhe
 - 10 pikë për 5 e më shumë produkte.
- Njohja e gjuhëve të huaja dhe aftësitë prezantuese, maksimum 10 pikë:
 - Gjuhë Angleze 5 pikë
 - Gjuhë Gjermane 4 pikë dhe
 - Gjuhë tjera 1 pikë.
- Materialet promovuese në gjuhët e huaja, maksimum 10 pikë:
 - Gjuhë Angleze 4 pikë
 - Gjuhë Gjermane 4 pikë dhe
 - Gjuhë tjera 2 pikë.
- Shtetet ku janë eksportuar shërbimet e subjektit aplikues gjatë vitit 2023, maksimum 10 pikë:
 - Shtetet e BE-së 5 pikë
 - Shtetet e CEFTA-së 3 pikë dhe
 - Shtetet tjera 2 pikë.

Certifikime ndërkombëtare të subjektit, maksimum 5 pikë:

- ISO 3 pikë dhe
- Certifikime tjera 2 pikë.
- Paraqitja e subjektit aplikues në panair apo dhe B2B takime në 5 vitet e fundit, maksimum 5 pikë:
 - 1 deri në 3 panair 3 pikë dhe
 - 4 deri në 6 panair 5 pikë.
- Qarkullimi vjetor i subjektit aplikues gjatë vitit fiskal 2023, maksimumi 10 pikë:
 - 0 - 500.000 euro 4 pikë
 - 500,001 – 1,000,000 euro 8 pikë dhe
 - > 1,000.000 euro 10 pikë.

Më 25.09.2024, në ora 14:00, në sallën e takimeve të KIESA-s, organizohet sesioni informues ku zyrtarët e KIESA-s do të përgjigjen pyetjeve lidhur me organizimin e panairit dhe mbështetjen e kompanive për pjesëmarrje në këtë panair. Subjektet që kanë nevojë për asistencë për plotësimin e këtij formulari, këshillohen gjithashtu të marrin pjesë në këtë takim.

Subjektet që dëshirojnë të aplikojnë për të marrë pjesë në panair duhet të shprehin interesimin e tyre duke plotësuar aplikacionin dhe ta dërgojnë bashkë me dokumentet e tjera në mënyrë elektronike më së largu deri më 10.10.2024 në e-mail adresën: Export.Kiesa@rks-gov.net

Në momentin e aplikimit subjekti pranon të gjitha përgjegjësitë, obligimet, kriteret dhe detyrat e parapara me legjislacionin në fuqi dhe kriteret e veçanta të parapara në këtë thirrje publike.

Informimi dhe pyetësori për shprehje të interesit mund të merren në KIESA-MINT apo të shkarkohen nga faqet e internetit:

mint.rks-gov.net dhe kiesa.rks-gov.net apo në e-mail adresën: Export.Kiesa@rks-gov.net

Stenda (pika kontaktuese) do të duket si me poshtë, ndërsa afër stendës janë edhe 330-350 hapësira (të hapura dhe të mbyllura) për takime B2B, ku do të kenë qasje të gjithë mbajtësit e tiketave për çdo takim që aranzhohet me kohë, tiketat do ndahen me subjektet pasi të janë përzgjedhur.

